



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.32

2004

27 maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9220 datë 15.4.2004	Për shërbimin publik të varrimit	2579
Ligj nr.9221 datë 15.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)"	2588
Ligj nr.9222 datë 15.4.2004	Për një shtesë në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", i ndryshuar.....	2589
Vendim i KM nr.300, datë 14.5.2004	Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion të hidrocentralit të Gizaveshit, Librazhd, si propozim i pakërkuar.....	2590
Vendim i KM nr.301, datë 14.5.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.294, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit të përdorimit të tokës në portin e Durrësit"	2590
Vendim i KM nr.303, datë 14.5.2004	Për domosdoshmërinë e plotësimit të kriterit të njohjes së gjuhës angleze nga ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për gradimin e radhës.....	2592
Vendim i KM nr.305, datë 14.5.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë, për bashkëpunim në fushat e shoqërisë së informacionit, të telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare	2592

Vendim i KM nr.306, datë 14.5.2004	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administratën e Përkohshme të Kosovës (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve	2595
Vendim i KM nr.307, datë 14.5.2004	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2004	2601
Vendim i KM nr.310, datë 14.5.2004	Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore, që do të ruhen nga Garda e Republikës së Shqipërisë pas lirimimit nga funksioni dhe për një ndryshim në vendimin nr.422, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore”.....	2602
Vendim i KM nr.311, datë 21.5.2004	Për kompensimin e qirasë së banesës për punonjësit e pastrehë të Gardës së Republikës të Shqipërisë, në rast transferimi	2602
Vendim i KM nr.312, datë 21.5.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.579, datë 8.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar i ushtarakëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, në rastet e nxjerrjes së tyre në rezervë, lirim apo pension”.....	2603
Vendim i KM nr.313, datë 21.5.2004	Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit.....	2604
Vendim i KM nr.314, datë 21.5.2004	Për një shtesë në vendimin nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e certifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar	2606
Vendim i KM nr.315, datë 21.5.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar.....	2608
Vendim i KM nr.317, datë 21.5.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degës së mobilizimit në qytetin e Librazhdit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	2608
Vendim i KM nr.320, datë 21.5.2004	Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe miratimin e formës së dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë.....	2609
Vendim i KM nr.323, datë 21.5.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”.....	2610

Vendim i KM nr.324, datë 21.5.2004	Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme	2611
Vendim i ERE nr.19, datë 29.4.2004	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “EMIKEL” sh.p.k	2612
Vendim i ERE nr.20, datë 29.4.2004	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “SPAHIU-GJANÇ” sh.p.k.	2613
Vendim i ERE nr.21, datë 29.4.2004	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “WONDER-POWER” sh.a”.....	2613
Vendim i ERE nr.22, datë 29.4.2004	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “ESSEGEI-SHQIPËRI-SMOKTHINA” sh.p.k.....	2614
Vendim i ERE nr.23 datë 30.4.2004	Për miratimin e sasisë së energjisë elektrike të përlogaritur për t'u faturuar aforfe për abonentët familjarë pa matës ose me matës jashtë kushtit teknik për periudhën 1 prill 2004-30 shtator 2004	2614
Vendim i ERE nr.24, datë 30.4.2004	Për miratimin e kërkesës së shoqatës KINDERHOUSE për ndryshim tarife.....	2615
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Liljana Sollaku..	2615
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Selim Sehti dhe caktim kujdestar pasurie.....	2615

LIGJ
Nr.9220, datë 15.4.2004

PËR SHËRBIMIN PUBLIK TË VARRIMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave e afateve për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Vdekje” është ndalimi i veprimtarisë jetësore të organizmit të njeriut.
2. “Kufomë” është trupi pa jetë i njeriut.
3. “Varr” është një gropë e hapur në tokë, për të futur kufomën.
4. “Varrezë” është një parcelë e veçantë toke, ku varrosen të vdekurit.
5. “Varrim” është ceremonia e fundit që i bëhet të vdekurit.
6. “Varrezë publike” është vendi ku ndodhen varrezat e një rajoni, të cilat janë pronë e bashkisë ose komunës.
7. “Mineralizim i kufomës” është dekompozimi i indeve të kockave, të cilat fitojnë cilësi minerare.
8. “Mbetje mortale” janë mbeturinat, që kanë mbetur pas mineralizimit të kufomës.
9. “Shërbim i varrimit” është veprimtaria që zhvillohet nga ndërmarrja publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrosjen e kufomës.
10. “Morg” është mjedisi për mbajtjen e kufomës në kushte frigoriferike.
11. “Periudha e observimit” është koha e mbikëqyrjes së kufomës para varrimit.
12. “Shenjë funebre” është çdo lloj simboli ose mbishkrimi i vendosur mbi varr nga familjarët.
13. “Zonë e rezervuar” është zona që nga banesa e fundit e periferisë së qytetit ose fshatit deri te fillimi i varrezave.

KREU II PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË VARRIMIT

Neni 3 Administrimi i varrezave

1. Çdo bashki ose komunë duhet të ketë të paktën një varrezë. Toka e caktuar për ndërtimin e varrezave është pronë publike.

2. Komunat, që përfshijnë disa fshatra, në të cilat transporti i kufomave deri në qendër të komunës nuk është i lehtë, për shkak të vështirësive të komunikacionit, duhet të kenë varreza të veçanta për këto fshatra.

3. Komunat e vogla mund të kenë një varrezë të përbashkët vetëm në qoftë se janë fqinje me njëra – tjetrën. Në këtë rast, me marrëveshje të përbashkët, shpenzimet për shërbimin dhe mirëmbajtjen e varrezave shpërndahen ndërmjet komunave, në bazë të të dhënave të popullsisë së tyre.

4. Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit vendor” bashkia ose komuna sigurojnë mirëmbajtjen, rregullin dhe ruajtjen e varrezave dhe kur varreza është e përbashkët këtë detyrë e kryen komuna ku ndodhet varreza. Këto veprime kryhen nga ndërmarrja publike vendore ose nga një shoqëri private e licencuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

5. Zyrat përgjegjëse të bashkisë ose komunës duhet të jenë të pajisura me një planimetri me shkallë 1 : 5000 të varrezave ekzistuese, e shtrirë në zonën rrethuese të tyre. Planimetria duhet të azhurnohet çdo vit, duke pasqyruar në të të gjitha ndryshimet e kryera.

6. Bashkia ose komuna, për administrimin e varrezave, bashkëpunon edhe me komunitetet fetare.

Neni 4 Zona e rezervuar

1. Varrezat duhet të jenë të izoluar nga zonat e banimit nëpërmjet zonës së rezervuar. Ndalohej të bëhen ndërtime të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brenda zonës së rezervuar.

2. Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10 000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 m nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10 000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 m.

3. Këshilli bashkiak ose komunal ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e zonës së rezervuar. Kjo bëhet vetëm me vendim të motivuar të organeve të mësipërme, duke marrë mendimin e inspektoratit sanitar.

Neni 5 Ndalimi i varrimit në një vend të ndryshëm nga varrezat

1. Varrosja e kufomave bëhet vetëm në varreza. Me kërkesë të komuniteteve fetare lejohet varrosja në mjediset brenda selive fetare. Kundërvajtësi dënohet me masë administrative me gjobë dhe të gjitha shpenzimet për transportimin e kufomës janë në ngarkim të tij.

2. Varret e vendosura në vende të ndryshme nga varrezat transferohen, pas periudhës së mineralizimit, në varrezat publike me shpenzimet e familjarëve.

Neni 6 Pranimi i kufomave në varreza

Në varrezat publike të bashkive dhe komunave pranohen:

a) kufomat e personave të vdekur në territorin e bashkive ose komunave, pavarësisht nga vendi i banimit kur ishin gjallë;

b) kufomat e personave të vdekur jashtë territorit të bashkive ose komunave, por që, kur ishin gjallë, ishin banues të tyre;

c) kufomat e personave që nuk banonin në këtë bashki ose komunë kur ishin gjallë dhe që kanë vdekur jashtë territorit të kësaj bashkie ose komune;

ç) kufomat e shtetasve të huaj me banim ose jo në Shqipëri, që dëshirojnë të varrosen në këto territore;

d) mbeturina mortale të personave të përmendur në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni;

dh) të lindurit të vdekur.

Neni 7

Shërbimi i varrimit

1. Pranë çdo bashkie ose komune funksionon shërbimi i varrimit. Përgjegjësi i këtij shërbimi merr në dorëzim dhe ruan për çdo varrim lejen e varrimit, të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile pranë bashkisë ose komunës. Ndalohet kryerja e varrimeve pa lejen përkatëse.

2. Kur vdekja ndodh në ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit kërkon dokumentet që vërtetojnë vdekjen, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe me këto dokumente bën deklarin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile në ditën e parë të punës.

3. Çdo shërbim varrimi regjistrohet në dy regjistra të njëjtë, numri i faqeve të të cilave vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkisë apo komunës. Në regjistër shënohen:

a) varrimet që janë kryer, duke saktësuar emrin, mbiemrin, moshën, vendin dhe datën e lindjes (siç rezulton nga leja e varrimit), vitin, ditën dhe orën e varrimit, numrin e gurit të varrit dhe numrin rendor të faturës së varrimit;

b) çdo ndryshim që ka ndodhur si pasojë e zhvarrosjeve.

Regjistri nënshkruhet në çdo fletë nga përgjegjësi i shërbimit. Modeli i tij përcaktohet në udhëzimin e ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

4. Njëra prej kopjeve të regjistrit dorëzohet çdo fund viti në arkivin e bashkisë ose komunës, ndërsa kopja tjetër mbetet në ruajtje pranë shërbimit të varrimit.

5. Rakordimi i regjistrave me zyrat e gjendjes civile bëhet çdo tremujor.

6. Regjistrat e përmendur në pikën 3 të këtij neni paraqiten pranë organeve të kontrollit të njësisë vendore pas çdo kërkesë të tyre.

KREU III

NORMAT TEKNIKE PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE

Neni 8

Projektimi i varrezave

1. Çdo projekt për zgjerimin e varrezave ekzistuese dhe ndërtimin e varrezave të reja bëhet në bazë të një studimi të plotë të zonës, të miratuar nga këshilli bashkiak ose komunal, veçanërisht, për sa i përket vendndodhjes, shtrirjes së tokës e natyrës fiziko-kimike të saj, thellësisë dhe drejtimit të shtresës hidrike.

2. Në projektet e ndërtimit të varrezave të reja mund të parashikohen edhe parcela të ndara sipas komuniteteve fetare, në funksion të përbërjes fetare të popullsisë së rajonit.

3. Normat teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

Neni 9

Vendmbajtja e përbashkët e eshtrave

Çdo varrezë ka vendmbajtjen e eshtrave, që përbëhet nga një ndërtesë e destinuar për mbledhjen e eshtrave, që vijnë nga zhvarrimet dhe që nuk janë kërkuar nga familjarët për destinacion tjetër në varreza. Vendmbajtja e eshtrave duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që eshtrat të mos shihen nga publiku. Vendmbajtja e eshtrave lejohet edhe brenda selive të komuniteteve fetare, pas marrjes së lejes nga bashkia ose komuna.

Neni 10

Krijimi i kushteve për kryerjen e riteve fetare

Planet rregulluese të varrezave parashikojnë vende të veçanta për kryerjen e riteve fetare, sipas kërkesave të komuniteteve fetare, në bazë të parimit të barazisë për të gjithë.

KREU IV

VARRIMET JASHTË VARREZAVE

Neni 11

Varrime të veçanta mbisipërfaqësore

Varrimi i veçantë mbisipërfaqësor i kufomave ose mbetjeve mortale në vende të ndryshme nga varrezat autorizohet me dekret të Presidentit të Republikës, duke respektuar normat e përcaktuara në këtë ligj. Autorizimi për këtë lloj varrimi bëhet kur ekzistojnë motive të justifikueshme për nderime të veçanta.

KREU V

PRISHJA E VARREZAVE

Neni 12

E drejta e prishjes së varrezave

1. Prishja e varrezës vendoset nga një komision i posaçëm, i ngritur nga këshilli bashkiak ose komunal, i cili harton dokumentin përkatës për verifikimin e gjendjes së plotë të varrezës, pasi është marrë mendimi i Inspektoratit Sanitar Shtetëror.

2. Ndalohet prishja e varrezave, që janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, përveç rasteve kur bëhet e domosdoshme për interesa publike.

Neni 13

Përdorimi i varrezës së prishur

1. Toka e një varreze, për të cilën është vendosur prishja, nuk destinohet për përdorim tjetër pa kaluar 15 vjet nga varrimi i fundit që bëhet në të. Gjatë kësaj periudhe, kjo varrezë mbetet nën mbikëqyrjen e bashkisë ose komunës, e cila organizon mirëmbajtjen e saj.

2. Përpara se të përdoret për qëllim tjetër, nga toka e varrezës duhet të hiqen me kujdes eshtrat në një thellësi jo më të madhe se 2 m dhe ato vendosen në ndërtesën e përbashkët të vendosjes së eshtrave ose në varrezën e re.

Neni 14

Materialet dhe shenjat funebre të varrezës së prishur

1. Materialet mbitokësore të varrezave, monumentet dhe shenjat funebre, të vendosura mbi varret që do të prishen, mbeten në pronësi të familjarëve, të cilët mund t'i transportojnë ato në varrezën e re.

2. Në rastet kur familjarët refuzojnë ta bëjnë këtë, këto materiale kalojnë në pronësi të bashkisë ose komunës.

3. Shpenzimet për ndërtimin dhe ripërshtatjen e monumenteve të varrezave, që kërkohen gjatë transferimit të mbetjeve ekzistuese, janë në ngarkim të familjarëve.

KREU VI MËNYRA E VARRIMIT

Neni 15 **Varrimi nëntokësor**

1. Varrimi nëntokësor bëhet në gropa të gërmuara dhe më pas të mbuluara me dhe. Kufomat duhet të vendosen në arkivole të lehta, që të dekompozohen me lehtësi. Çdo varr dallohet nga bordura anësore, pllaka e varrit, sipas një numri progresiv dhe identifikimi i kufomës.

2. Fushat e destinuara për këtë lloj varrimi shtrihen në toka të përshtatshme nga pikëpamja e strukturës gjeologjike dhe mineralogjike për vetitë mekanike dhe fizike, si dhe për nivelin e shtresës hidrike.

3. Kushtet e përdorimit të varrezës, të mënyrës së hapjes së varreve, si dhe të dhënat teknike të arkivoleve që do të përdoren, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

Neni 16 **Varrimi mbitokësor**

1. Varrimi mbitokësor ka të bëjë me vendosjen e kufomës në një dhomë të mbyllur hermetikisht me mur ose me pllaka guri. Në këtë mënyrë mund të vendosen edhe kufomat e balsamosura.

2. Kufomat e destinuara për varrim mbitokësor duhet të vendosen në arkivole me mure të dyfishta, njëri prej druri dhe tjetri prej metali.

3. Në arkivolin e jashtëm vendoset pllaka metalike, ku shënohen emri, mbiemri, data e lindjes dhe e vdekjes së kufomës.

4. Kushtet teknike të ndërtimit dhe të përdorimit të varrezave mbitokësore përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

KREU VII MËNYRAT E ZHVARRIMIT

Neni 17 **Zhvarrime të zakonshme nga nëntoka**

1. Zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka kryhen pas një periudhe 10-vjeçare nga viti i varrimit. Varret e liruara nga mbeturinat e arkivolit përdoren për varrime të reja.

2. Në rastet kur vërtetohet se pas periudhës 10-vjeçare nuk sigurohet mineralizimi i plotë i kufomave, bëhet zgjatja e kësaj periudhe me miratim të mjekut ligjor dhe, në mungesë të tij, të mjekut anatomo-patolog. Në rast se edhe pas kësaj periudhe nuk realizohet mineralizimi i plotë i kufomave, Ministria e Shëndetësisë vendos për transferimin ose jo të varrezave.

3. Kur vërtetohet se në një varrezë, për shkak të kushteve të veçanta të përbërjes apo strukturës së tokës, mineralizimi i kufomave kryhet për një periudhë më të shkurtër, mjeku ligjor dhe, në mungesë të tij, mjeku anatomo-patolog autorizon shkurtimin e kësaj periudhe jo më pak se 5 vjet.

4. Kryetari i bashkisë ose komunës lëshon lejet për zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka, të cilat kryhen nga ndërmarrja që administron varrezat.

Neni 18

Zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

1. Kufomat mund të zhvarrosen përpara periudhës së caktuar, me urdhër të gjyqtarit ose prokurorit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale ose me autorizimin paraprak të kryetarit të bashkisë ose komunës, për t'i transportuar në varr tjetër.

2. Për zhvarrimet e jashtëzakonshme nga nëntoka, të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, kufomat duhet të transportohen në sallat e autopsisë, duke respektuar kërkesat e bëra nga këto organe.

3. Të tilla zhvarrime duhet të kryhen në prani të grupit të mjekëve ligjorë, përfaqësues të organeve që e kanë kërkuar zhvarrimin dhe të të ngarkuarit me shërbimin e varrezave.

Neni 19

Rastet kur nuk mund të kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

Përveç rasteve të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, nuk kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka:

a) në muajt maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator, duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me varreza malore, ku lejohen procedurat e zhvarrimeve edhe në muajt e mësipërm;

b) në rastet e kufomave të personave të vdekur nga sëmundje infektive, përveç rasteve kur ka kaluar 2 vjet nga data e varrimit dhe kur zhvarrimi kryhet në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Neni 20

Depozitimi i eshtrave të zhvarrosura nga nëntoka

1. Eshtrat, që mblidhen si rezultat i zhvarrimeve të zakonshme, duhet të grumbullohen në vendin e tyre të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur varrosen në një parcelë të veçantë.

2. Eshtrat, si rezultat i zhvarrimeve të zakonshme, mund të propozohen në të njëjtin varr me një kufomë tjetër, sipas kërkesës së familjarëve.

3. Të gjitha mbeturinat e varrezave konsiderohen si mbeturina të veçanta dhe duhet të asgjësohen.

Neni 21

Zhvarrime të zakonshme mbitokësore

1. Zhvarrimet mbitokësore kryhen në mbarim të periudhës së lejes, që varion nga 5 deri në 20 vjet dhe bëhen me autorizim të kryetarit të bashkisë ose komunës.

2. Arkivolet e zhvarrosura varrosen nën tokë, pasi arkivolit t'i hapen disa të çara të përshtatshme, për të lejuar fillimin e procesit të mineralizimit të kufomës.

3. Kur kufomat e zhvarrosura gjenden në kushtet e një mineralizimi të plotë, me miratimin e mjekut anatomo-patolog, nga ndërmarja që administron varrezat mund të merren masa për mbledhjen e eshtrave në kasën e tyre.

Neni 22

Ndalimi i zvogëlimit të përmasave të kufomave

1. Ndalohet çdo veprim që ka të bëjë me zvogëlimin e përmasave të kufomës së varrosur mbi tokë, për ta futur në një arkivol me përmasa më të vogla se ato fillestare të arkivolit, me të cilin është varrosur.

2. Për rastet e parashikuara si vepër penale nga neni 118 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, përgjegjësi i shërbimit të rojes së varrezave bën kallëzim për ndjekje penale dhe ndërkohë vë në dijeni kryetarin e bashkisë ose komunës.

Neni 23

Zhvarrimet e jashtëzakonshme mbitokësore

1. Kryetari i bashkisë ose komunës autorizon zhvarrimin mbitokësor të arkivoleve të destinuara për t'u transportuar në një vend tjetër pas çdo periudhe kohe dhe në çdo muaj të vitit, me kusht që, pas hapjes së varrit mbitokësor, autoriteti sanitar vendor të verifikojë gjendjen e rregullt të arkivolit dhe të deklarojë se transferimi i tij nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin publik.

2. Kur autoriteti sanitar i sipërpërmendur vëren se arkivoli nuk është në gjendje të rregullt, mund të lejojë transferimin e tij, vetëm pasi të sistemohet në mënyrë të përshtatshme, sipas normave të përcaktuara në zbatim të këtij ligji.

KREU VIII

TRANSPORTIMI I KUFOMËS

Neni 24

Transportimi i kufomës në varrezë

1. Transportimi i kufomës nga vendi i vdekjes deri në morg ose në varrezë bëhet me automjete të mbyllura dhe nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e policisë bashkiake ose komunale.

2. Ndalohet të kryhet transportimi i kufomave përpara periudhës së observimit, të këshilluar nga grupi mjekësor, gjatë së cilës mund të shfaqen raste eventuale të kthimit në jetë.

3. Automjetet e varrimit duhet të plotësojnë kushte të veçanta, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike, të ministrit që mbulon veprimtarinë e transportit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 25

Leja për transportimin e kufomave

1. Transportimi i kufomave nga një bashki ose komunë në një tjetër autorizohet nga kryetari i bashkisë ose komunës, ku ka ndodhur vdekja.

Kryetari i bashkisë ose komunës pritëse duhet të lajmërohet për ardhjen e kufomës. Autorizimi i dorëzohet përgjegjësit të shërbimit të varrezave.

2. Për rastet kur kërkohet vendosja e kufomës në bashki ose komuna të tjera ndërmjetëse, për kryerjen e nderimeve të veçanta, autorizimi i lëshuar nga kryetari i bashkisë ose komunës u njoftohet edhe kryetarëve të njësive vendore ndërmjetëse.

3. I ngarkuari për transportimin e kufomës jashtë bashkisë ose komunës pajiset me autorizimin e kryetarit të bashkisë ose komunës, ku ka ndodhur vdekja.

4. Nëse transportimi kryhet me hekurudhë, anije ose avion, autorizimi i mësipërm duhet t'i dorëzohet transportuesit gjatë kryerjes së transportit.

Neni 26

Transportimi i eshtrave

1. Transportimi i eshtrave ose i mbetjeve të tjera mortale të asimilueshme, përveç autorizimit të përmendur në nenin 25 të këtij ligji, shoqërohet edhe me autorizimin e Inspektoratit Sanitar Shtetëror.

2. Eshtrat dhe mbetjet mortale të asimilueshme futen në çdo rast në kaseta zinku, me trashësi jo më të vogël se 0,6 mm dhe mbyllen me saldim. Mbi kasetë shënohen emri dhe mbiemri i kufomës.

3. Në rast se eshtrat ose mbetjet mortale janë të gjetura dhe nuk është i mundur identifikimi i tyre, në kasetë shënohen vendi dhe data e gjetjes.

Neni 27

Transportimi i kufomave për dhe nga jashtë shtetit

1. Kufomat, që transportohen për dhe nga jashtë shtetit, duhet të jenë të shoqëruara nga një dokument i veçantë. Ky dokument lëshohet nga prefekti, për kufomat që nxirren nga territori shtetëror dhe nga autoriteti përgjegjës i shtetit nga sillet kufoma, për kufomat që hyjnë në territorin shtetëror.

2. Për futjen në vend të kufomave, që vijnë nga shtetet e tjera, i interesuari për transportimin e kufomës duhet të paraqesë, nëpërmjet autoriteteve përkatëse ose personalisht, në autoritetin konsullor shqiptar, në shtetin ku ka ndodhur vdekja:

- a) kërkesën për lejen e transportimit të kufomës për në Shqipëri;
- b) certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse;
- c) certifikatën e organeve përgjegjëse, që vërteton se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës.

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga i interesuari me rrugë postare ose me faks.

Për shtetet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi diplomatike, kërkesa e mësipërme dërgohet në përfaqësinë, nga e cila mbulohet ai shtet.

3. Autoriteti konsullor shqiptar, pasi kontrollon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur dhe pasi bën verifikimin në autoritetet përkatëse që kanë lëshuar dokumentet e mësipërme, lëshon lejen për futjen e kufomës në Republikën e Shqipërisë. Leja i lëshohet drejtpërdrejt të interesuarit dhe autoritetit përkatës me postë ose me faks. Autoriteti konsullor shqiptar njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme, ministrinë që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike dhe prefektin e qarkut ose kryetarin e njësisë vendore ku do të çohet kufoma.

4. Për ekstradimin nga vendi të kufomave për në një shtet tjetër, i interesuari duhet t'i drejtojë një kërkesë prefektit të qarkut, ku ndodhet kufoma, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- a) miratimin për futjen e kufomës nga autoriteti konsullor i shtetit, në të cilin do të çohet kufoma;
- b) certifikatën e organeve shëndetësore përgjegjëse, ku vërtetohet se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës.

5. Prefekti, pasi merr kërkesën, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, lëshon autorizimin, duke njoftuar prefektin e qarkut të pikës kufitare nga do të kalojë kufoma.

6. Masa e shpenzimeve, procedura që do të ndiqet, institucioni që do të ngarkohet për përballimin e shpenzimeve të varrimit, për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë vendit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Kushtet e veçanta për transportimin e kufomave

1. Kufomat e destinuara për ekstradim jashtë territorit të vendit ose që duhet të transportohen në bashki ose komuna dhe me mjetin e zgjedhur të transportit mund të arrijnë vetëm pas 24 orëve, ose kur transportimi kryhet pasi kanë kaluar 48 orë nga çasti i vdekjes, duhet t'i nënshtrohen trajtimit antiprishje, duke injektuar në trupin e kufomës të paktën 500 cc formalinë, pasi të ketë kaluar periudha e observimit.

2. Kufomat që janë balsamosur nuk u nënshtrohen këtyre kushteve.

Neni 29

Transportimi i të vdekurve me sëmundje infektive

Kur vdekja ka ardhur si pasojë e një sëmundjeje infektive, ngjitëse, që bën pjesë në listën e veçantë të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë, transportimi i kufomës u nënshtrohet rregullave të veçanta, të përcaktuara me udhëzim të ministrit që mbulon këtë veprimtari.

KREU IX
SANKSIONET NDAJ SHKELËSVE

Neni 30

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) për shkelje të nenit 5 të këtij ligji, gjoba është në vlerën 30 000 lekë;
- b) për shkelje të neneve 4 pikat 1 dhe 2, 7 pika 1, 16 pikat 1 dhe 2, 17, 18 pika 3, 19 shkronjat “a” dhe “b”, gjoba është në vlerën 20 000 lekë;
- c) për shkelje të nenit 24 pikat 1 dhe 3, 25 pika 1, 28 pika 1, gjoba është në vlerën 25 000 lekë.

2. Policia bashkiake dhe policia komunale janë organet që vendosin gjobën dhe bëjnë ekzekutimin e saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

3. Në rast përsëritjeje të shkeljeve, policia bashkiake ose komunale bën pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë për subjektet shkaktare.

4. Kur këto shkelje përbëjnë vepër penale, policia bashkiake ose komunale bën kallëzim për ndjekje penale.

Neni 31

Ankimi

1. Ankimi kundër vendimit të policisë bashkiake ose policisë komunale bëhet te kryetari i bashkisë ose komunës, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Kryetari i bashkisë ose komunës duhet t’i përgjigjet ankimit brenda afatit kohor prej 30 ditësh.

2. Ankimi kundër vendimit të kryetarit të bashkisë ose komunës apo kur ky i fundit nuk kthen përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, bëhet brenda 30 ditëve nga marrja ose jo e njoftimit në gjykatën e rrethit.

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 27 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 3, 8, 15 pika 3 dhe 16 pika 4.

3. Ngarkohen ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike, ministri që mbulon veprimtarinë e transportit dhe Ministri i Shëndetësisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 24 të këtij ligji.

4. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4225, datë 14.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.9221, datë 15.4.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8366, DATË 2.7.1998 "PËR
SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 8 riformulohet si më poshtë:

"8. "Ujëra nëntokësore" nënkuptojnë ujërat e zonës së ngopjes, që formojnë shtresa, me dhe pa trysni.".

2. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

"9/1. "Shkenca të tokës" nënkupton të gjitha disiplinat kryesore, si gjeologjinë, gjeofizikën, gjeokiminë, mineralogjinë, topografinë, pedologjinë.".

Neni 2

Në nenin 3 të bëhen ndryshimet e shtesat si më poshtë:

1. Fjala "organ" zëvendësohet me fjalën "institucion".

2. Pas fjalës "teknik" shtohen fjalët "dhe shkencor".

3. Fjala "gjeologjike" zëvendësohet me fjalët "në fushën e shkencave të tokës".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës "të ndryshme" shtohen fjalët "në ndihmë të miradministrimit të territorit, burimeve minerare".

2. Në paragrafin e tretë, fjala "jometalore" zëvendësohet me fjalët "materialeve industriale".

3. Në paragrafin e katërt, pas fjalëve "baseneve ujore" shtohen fjalët "monitorimin e tyre" dhe pas fjalëve "rezerva ujore" shtohet fjala "nëntokësore".

4. Në paragrafin e pestë, pas fjalës "gjeologjike" shtohet fjala "komplekse" dhe pas fjalës "mjedisin" shtohen fjalët "dhe monitorimin e tij."

5. Pas paragrafit të shtatë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"- Studimet e thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë.".

Neni 4

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1

Personi fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujëra nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin në këshillat e baseneve, siç e përcakton ligji "Për rezervat ujore", duhet të marrë miratimin me shkrim për projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Personi i mësipërm depoziton në Arkivin Qendror të Gjeologjisë një kopje të projektit, pas miratimit të tij në Këshillin e Baseneve Ujëmbledhëse."

Neni 5

Në nenin 20, pas fjalës "specializimin" shtohen fjalët "dhe shpërblimin."

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4226, datë 14.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9222, datë 15.4.2004

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7651, DATË 21.12.1992 "PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", i ndryshuar, pas shkronjës "f " shtohet shkronja "g " me këtë përmbajtje:

"g) 14 Marsi – Dita e Verës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4227, datë 14.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.300, datë 14.5.2004

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION TË
HIDROCENTRALIT TË GIZAVESHIT, LIBRAZHID, SI PROPOZIM I PAKËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e Procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOO” (ndërtim, shfrytëzim, pronësi) të hidrocentralit të Gizaveshit, rrethi i Librazhdit, nga shoqëria “DARDANIA-ENERGJI” sh.p.k., Tiranë, si propozim i pakërkuar.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të jenë organi shtetëror i autorizuar (OShA), për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes koncesionare.

3. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.301, datë 14.5.2004

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.294, DATË 13.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRDORIMIT TË TOKËS NË PORTIN E
DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8383, datë 29.7.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes për kredinë e zhvillimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimin (IDA), për projektin e portit të Durrësit” dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.294, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a. Pas pikës 1 të shtohen pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 me këtë përmbajtje:

“1.1 Pjesa e planit të përdorimit të tokës në portin e Durrësit, e përcaktuar për portin e peshkimit, sipas pikës 1 të vendimit nr.294, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

1.2 Toka e kufizuar sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojë në administrim nga Autoriteti Portual Durrës, sh.a., Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, për ndërtimin e portit të ri të peshkimit.


1.3 Porti aktual i peshkimit në Durrës t’i kalojë në administrim Autoritetit Portual Durrës, sh.a., pas përfundimit të ndërtimit të portit të ri të peshkimit.”.

2. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Transportit dhe i

Telekomunikacionit, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit për përgatitjen e termave të referencës, kryerjen e studimit të fizibilitetit e të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



VENDIM
Nr.303, datë 14.5.2004

**PËR DOMOSDOSHMERINË E PLOTËSIMIT TË KRITERIT TË NJOHJES SË GJUHËS
ANGLEZE NGA USHTARAKËT E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËR GRADIMIN E RADHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për grada dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për gradimin e radhës sipas ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, duhet të plotësojë edhe kriterin e njohjes së gjuhës angleze, të përcaktuar sipas standardeve të NATO-s “STANAG 6001”.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.305, datë 14.5.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË,
PËR BASHKËPUNIM NË FUSHAT E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT,
TELEKOMUNIKACIONEVE DHE SHËRBIMEVE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë, për bashkëpunim në fushat e shoqërisë së informacionit, telekomunikacioneve dhe shërbimeve postare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHAT E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, TELEKOMUNIKACIONIT DHE SHËRBIMEVE POSTARE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, më poshtë referuar si “Palë”,

duke dëshiruar të zhvillojnë marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë,

duke ditur se komunikacionet efektive janë një faktor i rëndësishëm për t'i ngritur në një shkallë më të lartë këto marrëdhënie, si dhe zhvillimin ekonomik e social dhe mirëqënien e popujve të të dy vendeve,

duke shprehur interesin e përbashkët në vendosjen e bashkëpunimit më të ngushtë në fushat e shoqërisë së informacionit, telekomunikacioneve dhe shërbimeve postare, të bazuar në kushte të leverdisshme dhe të paanshme,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Lidhjet e telekomunikacioneve dhe postare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë do të bazohen në dispozitat e legjislacioneve kombëtare përkatëse, ligjit komunitar, rekomandimeve dhe akteve në fuqi të Bashkimit Postar të Përbotshëm (UPU), Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), Konferencës Europiane të Administratave Postare dhe të Telekomunikacioneve (CEPT) dhe Marrëveshjes në fjalë.

Neni 2

Palët do të marrin të gjitha masat brenda kompetencave të tyre për të zhvilluar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e lidhjeve postare dhe të telekomunikacionit ndërmjet dy vendeve dhe sigurimin e seriozitetit të tyre në përputhje me kërkesat e zhvillimit të shoqërisë së informacionit.

Neni 3

Palët do të inkurajojnë transitimin përmes vendeve të tyre të shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit dhe të programeve të radios dhe të televizionit të destinuar për, apo të ardhur nga, palët e treta, me kushtet më të favorshme.

Neni 4

4.1 Palët do të kryejnë bashkëpunimin nëpërmjet:

- shkëmbimit të informacionit dhe të dokumentacionit;
- konsultimeve dypalëshe;
- misionëve të ekspertëve dhe grupeve të punës;
- formave të tjera të bashkëveprimit sipas rastit.

4.2 Si rezultat i veprimtarive të parashikuara në këtë Marrëveshje, propozimet mund të bëhen për bashkëpunim më të ngushtë për çështje të caktuara. Për këtë qëllim, ndërmjet enteve postare dhe të telekomunikacionit të Palëve mund të nënshkruhen marrëveshje/memorandume mirëkuptimi.

Neni 5

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në përgatitjen e pikëpamjeve dhe/ose mbështetjes në lidhje me pjesëmarrjen në konferenca dhe forumet e organizatave ndërkombëtare të specializuara në

fushat e shoqërisë së informacionit, të telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të fokusohet, pa kufizim, në veprimtaritë e mëposhtme:

6.1 Harmonizimin e legjislacionit të brendshëm në fushat e shoqërisë të informacionit, të telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian.

6.2 Vendorsjen e pranimeve të tregut në sektorët e shoqërisë të informacionit, telekomunikacioneve dhe të shërbimeve postare, duke përfshirë liberalizimin e shërbimeve përkatëse.

6.3 Menaxhimin e frekuencave, duke synuar një përdorim optimal të spektrit të radio frekuencave.

6.4 Zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

6.5 Promovimin e arritjeve më të fundit të teknologjive globale të informacionit dhe të telekomunikacioneve.

6.6 Çështje të tjera të rëna dakord nga Palët.

Neni 7

Palët do të mbështesin dhe do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet enteve përkatëse të të dyja Palëve në fushat e shoqërisë së informacionit, telekomunikacioneve dhe shërbimeve postare.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe me palët e treta ose marrëveshjet shumëpalëshe që zbatohen në dy vendet.

Neni 9

9.1 Autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë:

Në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacioneve.

Në Republikën e Bullgarisë: Ministria e Transportit dhe e Komunikacioneve.

9.2 Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën, në kohën e duhur, për çdo ndryshim në lidhje me këto autoritete kompetente.

Neni 10

Për korrespondencën në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes në fjalë, dy Palët do të përdorin gjuhën angleze.

Neni 11

Palët do të bëjnë përpjekje maksimale për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që dalin nga interpretimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së pranishme përmes bisedimeve dhe konsultimeve të drejtpërdrejta.

Neni 12

Secila Palë do të jetë e detyruar të mos zbulojë informacionin e marrë apo të dalë sipas kësaj Marrëveshjeje për një palë të tretë, pa miratimin me shkrim të Palës së cilës i përket informacioni.

Neni 13

13.1 Çdo palë mund të propozojë ndryshime dhe/ose shtesa me shkrim në Marrëveshjen e pranishme, të cilat do t'i nënshtrohen mirëkuptimit të përbashkët.

13.2 Amendamentet dhe/ose shtesat sipas paragrafit paraardhës do të hyjnë në fuqi sipas paragrafit 1 të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

14.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë nga data e marrjes së notës së dytë diplomatike të dy notave me të cilat Palët bashkërisht njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin e brendshëm përkatës të tyre.

14.2 Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme deri në një afat të pacaktuar dhe secila Palë mund ta shpallë të pavlefshme me shkrim. Në një rast të tillë Marrëveshja përfundon me mbarimin e afatit të 6 muajve nga data e marrjes së notës diplomatike me të cilën Pala tjetër është njoftuar për aktin e pavlefshmërisë.

Bërë, më 30 mars 2004 në Tiranë në dy origjinale në gjuhën angleze, ku të dy tekstet janë autentikisht të njëjta dhe kanë të njëjtën vlerë.

VENDIM

Nr.306, datë 14.5.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ADMINISTRATËN E PËRKOHSHME TË KOSOVËS (UNMIK), NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administratën e Përkohshme të Kosovës (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISSIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ADMINISTRATËN E PËRKOHSHME TË KOSOVËS (UNMIK) NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administratën e Përkohshme të Kosovës në emër të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në Kosovë, këtu më poshtë të referuara si “Palë”,

duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik për përfitimin reciprok të vendeve,

duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës Palë në territorin e Palës tjetër,

duke njohur se nxitja dhe mbrojtja e investimeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të stimulojë iniciativat investuese në këtë fushë,

ranë dakord si vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “investitor” kupton:

a) një person fizik i cili, në përputhje me ligjin e Palës përkatëse, është një shtetas i Republikës së Shqipërisë ose një banor i përhershëm i Kosovës dhe është duke bërë investime në territorin e Palës tjetër;

b) një njësi ligjore, duke përfshirë shoqëritë, shoqatat, shoqëritë e përbashkëta dhe çdo lloj tjetër organizimi të inkorporuar apo të krijuar, ose me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e njëres Palë e cila ka adresën e saj ligjore, apo vend kryesor të biznesit të saj në territorin e kësaj Palë dhe është duke bërë investime në territorin e Palës tjetër.

2. Termi “investim” kupton çdo lloj pasurie, siç janë paratë apo monedhë ekuivalente me to që zotërohen nga një investitor me qëllim profiti dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, më poshtë:

a) pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e shoqërive apo shoqatave dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në një shoqëri;

b) pretendimet në para apo të çdo forme tjetër në bazë të një kontrate që ka vlerë ekonomike dhe pjesëmarrja lidhur me një investim;

c) pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo të drejtë tjetër, si hipotekat, qiratë, uzufrukti, pengjet dhe të drejta të ngjashme;

d) të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale, si patentat, licencat, markat tregtare, emrat tregtarë, si dhe proceset teknike, *know-how* dhe dëshira e mirë;

e) të drejtat për të ndërmarrë veprimtari ekonomike dhe tregtare në bazë të ligjit apo të një kontrate, duke përfshirë koncesionet për studimin, kërkimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Çdo ndryshim në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk do të prekin karakterin e tyre si investim, në rast se ky ndryshim është kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat e Palës pritëse të investimit.

3. Termi “të ardhura” kupton shumat që rrjedhin nga një investim dhe përfshin në veçanti, por jo ekskluzivisht, fitimin, dividendët, interesin, rritjen e kapitalit, shpërblime dhe të ardhura të tjera.

4. Termi “territor” kupton:

- lidhur me Republikën e Shqipërisë, territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë përfshirë ujërat territoriale dhe zonën detare e shelfin kontinental, mbi të cilat Republika e Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat e saj sovraane e ligjore;

- lidhur me Kosovën, territorin nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut sipas përcaktimit në rezolutën 1244 (1999) në 10 qershor 1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 2 **Nxitja dhe pranimi**

1. Çdo Palë do të nxisë dhe do të krijojë kushte të favorshme për investitorët e Palës tjetër, për të bërë investime në territorin e saj dhe do t'i pranojë këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e saj.

2. Kur një Palë ka pranuar një investim në territorin e saj, ajo do të japë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj, lejet e nevojshme që janë të lidhura me këtë investim dhe kryerjen e marrëveshjeve të licencimit dhe kontratave për asistencë teknike, tregtare apo administrative. Çdo Palë është e detyruar të lëshojë, nëse kërkohen, autorizimet e nevojshme në lidhje me aktivitetin e konsultimit dhe për persona të tjerë të kualifikuar.

Neni 3 **Mbrojtja**

1. Investimeve të bëra nga investitorët e njëres Palë në territorin e Palës tjetër, në çdo kohë, do t'u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtjen dhe siguri të plotë ligjore. Në asnjë rast një Palë nuk do t'u japë këtyre investimeve trajtimin më pak të favorshëm sesa ai i kërkuar nga e drejta ndërkombëtare, sipas përcaktimit në nenet 4 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Asnjëra Palë nuk do të pengojë në asnjë mënyrë, nëpërmjet masash arbitrare ose diskriminuese, operimin, menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, shitjen dhe nëse është rasti edhe likuidimin e këtyre investimeve referuar në paragrafin 1 të këtij neni. Çdo Palë do të vëzhgojë çdo detyrë që ka të bëjë me investimet e investitorëve të Palës tjetër.

Neni 4 **Trajtimi vendor dhe i kombit më të favorizuar**

1. Çdo Palë do t'u japë në territorin e saj, investimeve ose të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo u ka dhënë investimeve apo të ardhurave të investitorëve vendorë apo sesa ai që ajo u ka dhënë investimeve dhe të ardhurave të investitorëve të një Palë të tretë, cilido është më i favorshëm për investitorin në fjalë.

2. Ky trajtim nuk do të shtrihet te privilegjet të cilat secila Palë mund t'u japë investitorëve të një palë të tretë për shkak të anëtarësimit të tyre apo përfshirjes në ndonjë zonë të tregtisë së lirë, bashkimi doganor, tregu të përbashkët ose ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të ngjashme, ekzistuese apo që do të krijohet në të ardhmen, te të cilat cilado prej Palëve është ose mund të bëhet palë.

3. Secila Palë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit të saj, do t'u japë investimeve apo të ardhurave të investitorëve të Palës tjetër një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u ka dhënë investimeve apo të ardhurave të investitorëve të vet.

4. Trajtimi i dhënë në këtë nen nuk do të konsiderohet si detyrim për një Palë që të shtrijë tek investitorët e Palës tjetër përfitimet e çdo trajtimi, preference apo privilegji që rezultojnë nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin, përfshirë çdo marrëveshje për evitimin e taksimit të dyfishtë, ose çdo ligj kombëtar që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me taksimin.

Neni 5 Shpronësimi

1. Investimet ose të ardhurat e investitorëve të secilës prej Palëve në territorin e Palës tjetër nuk do të shpronësohen, të përdoren ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që ka efekt ekuivalent me atë të shpronësimit apo të përdorimit (këtu më poshtë referuar si "përdorim"), me përjashtim kur kërkohet për interes publik, mbështetur në ligj, mbi baza jodiskriminuese dhe kundrejt një pagese të menjëhershme të përshtatshme dhe kompensimi efektiv.

2. Investitori i prekur, gëzon të drejtën, sipas ligjit dhe rregullave të Palës që bën përdorimin, për një shqyrtim të menjëhershëm nga ana e autoriteteve gjyqësore apo kompetente dhe të pavarura të kësaj Pale, të rastit të tij dhe të përcaktojë nëse ky shpronësim dhe vlerësim i investimit të saj është në përputhje me parimet e vendosura në këtë nen.

3. Ky kompensim do të llogaritet me vlerën e tregut të investimit të përdorur, në momentin përpara se masa e shpronësimit të kryhet ose përpara se ky përdorim të bëhet publikisht i njohur. Kompensimi do të përfshijë interesin LIBOR për një vit deri në datën e pagesës, do të paguhet pa vonesë, në një monedhë lirisht të konvertueshme dhe do të jetë efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

Neni 6 Kompensimi për humbjet

1. Investitorëve të një Pale, investimet apo të ardhurat e të cilëve pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër për shkak të konfliktit të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës, kryengritjeve, luftës civile ose ngjarjeve të ngjashme, do t'u jepet nga Pala e fundit në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose ndonjë zgjidhje tjetër të vlefshme, një trajtim jo më pak i favorshëm sesa kjo Palë u jep investitorëve vendorë ose të një pale të tretë, cilido qoftë më i favorshmi prej tyre për investitorin. Pagesat e rezultuara do të jenë lirisht të transferueshme.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, një investitori të një Pale, i cili, në secilën nga situatat e referuara në këtë paragraf, pëson humbje në territorin e Palës tjetër, që rezultojnë nga:

- a) shpronësimi i investimit apo i një pjese të tij, apo autoritetet e kësaj të fundit;
 - b) shkatërrimi i investimit ose i një pjese të tij nga autoritetet e kësaj të fundit, që nuk ishte i nevojshëm për situatën,
- do t'i jepet nga Pala e fundit dëmshpërblimi apo kompensimi.

3. Kompensimi në çdo rast do të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat e rezultuara do të bëhen pa vonesë në monedhë lirisht të konvertueshme dhe lirisht të transferueshme.

Neni 7 Transferimet

1. Çdo Palë do t'u garantojë investitorëve të Palës tjetër, në përputhje me ligjet dhe rregullat e Palës pritëse, transferimin e lirë të të gjitha pagesave për detyrimet fiskale që kanë të bëjnë me investimet e tyre. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

- a) kapitalin fillestar dhe çdo shtesë në kapital për mirëmbajtjen apo rritjen e një investimi;
- b) të ardhurat nga investimi;
- c) fondet për shlyerjen e huave në lidhje me një investim;
- d) kompensimet që jepen në bazë të nenit 5 dhe 6 dhe pagesat që kryhen për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, sipas neneve 10 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje;
- e) të ardhurat nga shitja ose likuidimi i plotë apo i pjesshëm i një investimi;
- f) të ardhurat dhe shpërblime të tjera të personelit të angazhuar nga jashtë në lidhje me një investim.

2. Transferimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhen pa vonesë dhe në një monedhë lirisht të transferueshme me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transferimit.

3. Palët do t'u japin transferimeve referuar në këtë nen një trajtim jo më pak të favorshëm

sesa ai që i është dhënë transferimit të pagesave që rrjedhin nga investimet e bëra nga investitorët e ndonjë pale të tretë.

Neni 8 **Kushtet më favorizuese**

Nëse legjislacioni i ndonjëres prej Palëve ose detyrimet që rrjedhin sipas së drejtës ndërkombëtare ekzistuese apo të vendosur më vonë midis Palëve si plotësim i kësaj Marrëveshjeje, përmbajnë një rregullim, qoftë ky i përgjithshëm apo i veçantë, që u jep investitorëve të Palës tjetër një trajtim më të favorshëm sesa ai i dhënë nga kjo Marrëveshje, ky rregullim do të jetë mbizotërues për atë që ai është më i favorshëm kundrejt kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 **Zëvendësimi më të drejta të plota (subrogimi)**

1. Nëse një Palë ose agjencia e përcaktuar prej saj bën një pagesë për një zhdëmtim, garanci apo kontratë sigurimi kundrejt një risku jotregtar në lidhje me një investim të bërë nga ndonjë prej investitorëve të saj në territorin e Palës tjetër, Pala e fundit do të njohë kalimin e çdo të drejte apo detyrim të këtij investitori tek ish-Pala apo agjencia e përcaktuar prej saj, që të ushtrojë në bazë të zëvendësimit më të drejta të plota, çdo të drejtë në të njëjtën masë sa edhe paraardhësi i tij.

2. Ky zëvendësim do të bëjë të mundur që ish-Pala apo agjencia e përcaktuar prej saj të jetë direkt përfituese e çdo pagese për dëmshpërblim apo kompensim tjetër, që mund të ngarkohet të kryejë investitori.

3. Zëvendësimi i të drejtave dhe i detyrimeve për investitorin e zhdëmtuar do të aplikohet, gjithashtu edhe për transferimin e pagesave efektive në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve**

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për sa është e mundur, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet në këtë mënyrë brenda gjashtë (6) muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet me kërkesën e njëres prej dy Palëve, një gjykate arbitrazhi.

3. Gjykata e arbitrazhit do të krijohet në mënyrën e mëposhtme: çdo Palë do të emërojë një gjykatës dhe këta dy gjykatës do të zgjedhin një të tretë, i cili do të jetë kryetar. Në qoftë se brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrim Pala tjetër nuk ka emëruar një gjykatës, ose brenda 60 ditëve nga emërimi i dy gjykatësve, gjykatësi i tretë nuk ka qenë emëruar, Pala tjetër mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të emërojë një gjykatës.

4. Gjykata do të nxjerrë vendimet e saj në bazë të respektimit të ligjeve të aplikuara në territoret e Palës, dispozitave që përmban kjo Marrëveshje, si dhe parimeve universale të së drejtës ndërkombëtare.

5. Gjykata e arbitrazhit i përcakton vetë procedurat.

6. Gjykata e arbitrazhit do të marrë vendimet me shumicë votash. Vendimi i arbitrazhit duhet të cekë arsyet në bazë të të cilave është marrë vendimi dhe ky vendim do të jepet përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët.

7. Çdo Palë do të përballojë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej tij dhe ato të përfaqësimit në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e tjera përfshirë dhe ato të presidentit do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja Palët.

Neni 11

Mosmarrëveshjet ndërmjet njëres Palë dhe një investitori të Palës tjetër

1. Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen ndërmjet njëres Palë dhe një investitori të Palës tjetër në lidhje me një investim, do të paraqiten me shkrim, përfshirë dhe një informacion të detajuar, nga investitori tek Pala pritëse e investimit. Për sa të jetë e mundur, palët e interesuara do të përpiqen ta zgjidhin këtë mosmarrëveshje në mënyrë miqësore.

2. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data kur njoftimi me shkrim referuar paragrafit 1 është shtruar për zgjidhje, mosmarrëveshja do t'i nënshtrohet, sipas zgjedhjes së investitorit:

- gjykatës kompetente të Palës në territorin e së cilës investimi është kryer ose
- një gjykatë arbitrazhi të përkohshme të krijuar sipas Rregullave të Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Tregtar Ndërkombëtar (UNCITRAL);
- Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) të krijuar nga Konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, e hapur për nënshkrim në Washington D.C., në 18 mars 1965, në rastin kur të dyja Palët janë anëtare të kësaj Konvente.

3. Arbitrimi do të bazohet në:

- dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- rregullat dhe parimet universale të së drejtës ndërkombëtare;
- ligjet që zbatohen në territorin e Palës, në territorin e së cilës është bërë investimi, përfshirë rregullat lidhur me konfliktet në ligj.

4. Dispozitat e nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, një Palë nuk do t'i shfrytëzojë për mbrojtje, dëmshpërblim apo kompensim për të gjithë apo për një pjesë të dëmit të pësuar, që është marrë apo do të merret nga investitori në bazë të një kontrate garancie apo sigurie.

5. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Palët në mosmarrëveshje. Secila Palë merr përsipër që të zbatojë vendimet në përputhje me legjislacionin e vendit të saj.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën se formalitetet e brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje janë përfunduar. Ajo do të zbatohet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë fillestare prej 5 vjetësh dhe mund të rinovohet automatikisht, nëse nuk kundërshtohet nga njëra Palë, për një periudhë të mëtejshme prej 5 vjetësh.

2. Secila Palë mund të përfundojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, të paktën 6 muaj përpara datës së përfundimit të saj.

3. Për investimet e bëra para datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të mëtejshme gjatë së cilës ato kanë qenë efektive përpara përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 19 shkurt 2004 në dy origjinale në gjuhët shqip dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë.

Në rast mosmarrëveshje në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

PËR INSTITUCIONET E PËRKOSSHME
VETËQEVERISËSE NË KOSOVË

Ali Jakupi
MINISTËR PËR TREGTI

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anastas Angjeli
MINISTËR I EKONOMISË

PËR MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR ADMINISTRATËN E PËRKOHSHME TË
KOSOVËS
NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË
Harri Holkeri
PËRFAQËSUES SPECIAL I SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM

VENDIM
Nr.307, datë 16.4.2004

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2004, në shumën 242 000 000 (dyqind e dyzet e dy milionë) lekë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJE 1
**STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2004**

Nr.	Emërtimi	Milionë lekë
	Shpenzime gjithsej:	242
1	Fond page dhe sigurime shoqërore	37
2	Shërbime	23
2.1	Kualifikimi i stafit	5
2.2	Shërbime bazë	6
2.3	Shërbime social-kulturore	3.5
2.4	Udhëtim e dieta	6.5
2.5	Shërbime të tjera	2
3	Investime	182
3.1	Ngritja e qendrës së monitorimit dhe e kontrollit të frekuencave	100
3.2	Asistencë e huaj për hartimin e metodologjisë së kontrollit të tarifave të operatorëve celularë	10
3.3	Asistencë e huaj për hartimin e kuadrit rregullator për licencimin e operatorëve në zonat urbane dhe ndërrurbane	9.5
3.4	Studimi i tregut dhe i shfrytëzimit të brezave wireless	11.5
3.5	Projektimi i qendrës së monitorimit	6.2

3.6	Informatizimi i ERT-së	10
3.7	Ndërtim godine shtesë	20
3.8	Blerje pajisje zyrash	5.7
3.9	Blerje motor gjenerator, automjete, kondicionerë etj.	9.1

VENDIM
Nr.310, datë 14.5.2004

PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE, QË DO TË RUHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PAS LIRIMIT NGA FUNKSIONI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.422, DATË 12.9.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të neni 5 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zëvendëskryeministri ruhet dhe mbrohet nga Garda e Republikës së Shqipërisë edhe dy vjet të tjera pas lirimimit nga funksioni.
 2. Pika 6 e vendimit nr.422, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik dhe komandanti i Gardës së Republikës të Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.311, datë 21.5.2004

PËR KOMPENSIMIN E QIRASË SË BANESËS PËR PUNONJËSIT E PASTREHË TË GARDËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË, NË RAST TRANSFERIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 37 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e pastrehë të Gardës së Republikës të Shqipërisë, në rast transferimi për nevoja pune e shërbimi jashtë vendbanimit, përfitojnë shpërblimin mujor për kompensimin e qirasë së banesës, deri në sigurimin e banesës nga shteti, në masën dhe kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:
 - a) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese të tipit garsonierë, kur nuk ka persona të tjerë në ngarkim;

b) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese të tipit 1+1, kur ka në ngarkim deri në dy persona;

c) 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese të tipit 2+1, kur ka në ngarkim më shumë se dy persona.

Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet, çdo vit, nga Garda e Republikës, duke u bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikës (INSTAT).

2. Punonjësit që përfitojnë shpërblim mujor për banesë, duhet të paraqesin pranë Gardës së Republikës, këto dokumente:

a) kërkesën për kompensimin e qirasë;

b) certifikatën personale;

c) certifikatën familjare;

ç) vërtetimin, si i pastrehë, nga organet e pushtetit vendor, ku ka vendbanimin;

d) vërtetimin nga dega e tatim-taksave, për mosushtrim veprimtarie private;

dh) kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Rendit Publik.

4. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.312, datë 21.5.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.12.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUSHTET DHE MASËN E PËRFITIMEVE NGA SIGURIMI SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE, NË RASTET E NXJERRJES SË TYRE NË REZERVË, LIRIM APO PENSION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar”, të ndryshuar dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “B” të kreut II të vendimit nr.579, datë 8.12.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Paga referuese e ushtarakut të Forcave të Armatosura, që ka dalë në rezervë apo lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8521, datë 30.7.1999 dhe e drejta për të përfutur i ka lindur pas datës 1.1.2004, përfshirë edhe këtë datë, përbëhet nga:

- paga bazë për gradë, sipas viteve të shërbimit;

- shtesa për kushte të veçanta pune e shërbimi;

- shtesa për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin.”.

b. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Paga bazë mujore për efekt shpërblimi, që përfiton ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, të jetë paga bazë për gradë, sipas viteve të shërbimit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.313, datë 21.5.2004

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 57, 58 dhe 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit, për të drejtën e dhënies së lejes apo koncensionit, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Të ardhurat e realizuara nga tarifat e përdorimit të ujit, që mblidhen nga autoritetet përkatëse, të derdhen në llogarinë e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit e të planifikohen në buxhetin vjetor të shtetit miratuar për këtë ministri. Këto të ardhura të përdoren vetëm për shfrytëzimin e rezervave ujore.

3. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

TARIFAT E PËRDORIMIT TË UJIT

PËRDORIMET	PËRDORUESIT	E DREJTA E DHËNIES	TARIFA		
			Njësia	Ujë sipërfaqësor	Ujë nëntokësor
Nevoja Shtëpiake	Private (Ujë nëntokësor që nxirret me pompa për pirje dhe nevoja të tjera)	Leje	M3	-	28
Qëllimi publik	Ndërmarjet e ujësjellësit - Prodhim deri 10 milion m ³ /vit	Koncension	M3		0.8
	Ndërmarjet e ujësjellësit - Prodhim deri 20 milion m ³ /vit	Koncension	M3		0.5
	Ndërmarjet e ujësjellësit - Prodhim mbi 20 milion m ³ /vit	Koncension	M3	0.2	0.3
	Ujësjellës fshati	Koncension	M3		0.2
Përdorime Industriale dhe Tregëtare					
	Ndërmarje paketime (Ujë natyral)	Koncension	M3		120
	Ndërmarje paketime (Ujë mineral)	Koncension	M3		160
	Organizma tregëtare (lokal, lavazh, përpunim mermeri, etj) Burim	Leje	M3		120
	Prodhim pije alkoolike dhe joalkoolike	Leje	M3		150
	Ujë për proces teknologjik	Leje	M3	50	80

VENDIM
Nr.314, datë 21.5.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.352, DATË 3.5.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË SË PASURIVE
TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe të nenit 12/1 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas lidhjeve, që i bashkëlidhen vendimit të shtohet lidhja “Certifikata provizore për regjistrimin e karabinasë”, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
RRETHI _____

CERTIFIKATE PROVIZORE
PER REGJISTRIMIN E KARABINASE

Vërtetohet se në regjistrin provizor të karabinase me nr. _____ datë ____/____/____, figuron e regjistruar në pronësi të:

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

Pasuria me numër _____ e ndodhur në Zonën Kadastrale _____ me sipërfaqe _____ m², në adresën _____

Kufizimet e pasurisë janë:

V _____, L _____
J _____, P _____

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme:

nr. Hip. _____, datë: ____/____/____	nr. Hip. _____, datë: ____/____/____
nr. Hip. _____, datë: ____/____/____	nr. Hip. _____, datë: ____/____/____
nr. Hip. _____, datë: ____/____/____	nr. Hip. _____, datë: ____/____/____

Barrë mbi pasurinë: _____

Komente nga Regjistruesi: _____

Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartë Treguese të Regjistrimit Provizore.

Ky formular miratohet për vërtetimin e pronësisë deri në përfundimin e Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr.7843, datë 13/07/1994.

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas kërkeses
Nr. _____, Date: ____/____/____
paraqitur pranë **ZRPP** _____.

REGJISTRUESI

Datë: ____/____/____

VENDIM
Nr.315, datë 21.5.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 shkronja “c”, 20 shkronja “ë” dhe “g”, e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e kreut I të vendimit nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet si më poshtë vijon:

“2. Orari ditor i punës fillon çdo ditë në orën 8.00 dhe përfundon në orën 16.30, ndërsa ditën e premte fillon në orën 8.00 dhe përfundon në orën 14.00.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.317, datë 21.5.2004

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË DEGËS
SË MOBILIZIMIT NË QYTETIN E LIBRAZHIDIT, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME,
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të degës së mobilizimit në qytetin e Librazhdit t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, për t’u përdorur për sistemin e drejtorisë arsimore në Librazhd.

2. Prona me numër rendor 769 “Dega e mobilizimit” në Librazhd, së bashku me të gjitha elementet përbërëse, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës i ndalohet t’ia ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ia japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.320, datë 21.5.2004

**PËR CAKTIMIN E ELEMENTEVE TË SIGURISË DHE MIRATIMIN E FORMËS SË
DOKUMENTIT TË IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 shkronja “d” e “8” të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Caktimin e elementeve të sigurisë dhe miratimin e formës së dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS

**ELEMENTET E SIGURISË DHE FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT TË
SHTETASVE SHQIPTARË**

I. ELEMENTET E SIGURISË

1. Dokumenti është prej materiali teslin.
2. Elemente biometrike të dokumentit:
 - a) fotografia e mbajtësit me ngjyra;
 - b) gjurma e gishtit (e sheshtë), sipas standardit EC 1683/95, e ruajtur në barkod (barcode).
3. Holograme e integruar në dokument me këto karakteristika:
 - e personalizuar, me përmasa 2.5 cm², në pjesën e përparme të dokumentit;
 - e metalizuar, me 2D/3D realizuar me teknika të ndryshme;
 - sipas këndit të ndriçimit shfaq figura, shkrime dhe ngjyra të ndryshme, duke pasqyruar dritën sipas ngjyrave të ylberit;
 - mikrotekst në sfond (të hologramës).
4. Fotografi e dubluar e mbajtësit, me madhësi sa një e treta e fotografisë kryesore.
5. Elemente të sigurisë së shtypit:
 - a) shtypi është me teknikën e shtypit Rainbow;
 - b) kompozicioni Guilloch në sfondin e sigurisë së dokumentit, në të dyja anët e dokumentit, me elemente kundër skanimit (security background);
 - c) simbol me bojë fluoreshente të padukshme, me sipërfaqe 3 cm², i dukshëm në dritën UV (Ultra Vjollcë);
 - d) mikroteks pozitiv (pozitive mikroprint) në formë shiriti ose në bllok, me sipërfaqe 1 cm², që bëhet i dukshëm nga zmadhimi me lupë x 10.
 - e) mbrojtje e fotografisë me një shtresë e holografike.
6. Elemente të tjera:
 - a) barkodi 2D (dy dimensional), ku futet pjesa e elementeve të personalizimit të të dhënave të mbajtësit, që nuk është pasqyruar në tekstin e dukshëm;
 - b) nënshkrimi i mbajtësit;
 - c) numri serial i dokumentit në pjesën e përparme të dokumentit.

II. FORMA

Dokumenti i identitetit është i formatit ID1 dhe përmasat e tij janë: lartësia 53,92/54,03 mm, gjerësia 85,47/85,72 mm, trashësia 0,8/0,84mm.

VENDIM
Nr.323, datë 21.5.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE,
SHOQËRIVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private, të pavarura dhe të privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kapitullin I të vendimit nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Institucionet qendrore dhe vendore vendosin kritere shtesë për objektet, që jepen me qira për qëllime kulturore, sportive dhe arsimore."

2. Në pikën 4 shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

“c) Objektet, të cilave u ka përfunduar afati i qirasë dhe organi i varësisë administrative është shprehur dakord për shtyrjen e afatit të kontratës, pasi qiramarrësi:

- ka plotësuar detyrimet e përcaktuara në kontratën e përfunduar;
- ka realizuar investimet e përcaktuara;
- ka realizuar nivelin e punësimit;
- ka shlyer të gjitha detyrimet e qirasë;
- merr përsipër kryerjen e investimeve shtesë;
- merr përsipër rritjen e nivelit të punësimit.

Afati i zgjatjes së kontratës të jetë:

- për objektet me sipërfaqe 201-500 m², deri në 5 vjet;
- për objektet me sipërfaqe mbi 501 m², jo më shumë se koha e mbetur nga afati maksimal i parashikuar në këtë vendim (deri në 20 vjet).

Llogaritja e vlerës së qirasë të bëhet me çmimin dysHEME dhe me vlerën e kontratës së parë, kur ajo është më e madhe se çmimi dysHEME.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.324, datë 21.5.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE PËR
STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të cilët gëzojnë të drejtën e gradës, paguhen në bazë të gradës diplomatike/konsullore, e cila përcaktohet në lidhjen 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, emërohen:

a) “Përgjegjës sektori” nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i parë” apo të barasvlefshme me të;

b) “Drejtor drejtorie” nëpunësit e shërbimit të jashtëm me gradë diplomatike jo më të ulët se “Këshilltar” apo të barasvlefshme me të;

c) “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme” nëpunësit e shërbimit të jashtëm me gradë diplomatike jo më të ulët se “Ministër këshilltar” ose “Ministër fuqplotë” apo të barasvlefshme me to.

3. Kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm me gradë më të lartë se ajo e përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 2 këtij vendimi, ata paguhen sipas gradës diplomatike/konsullore që kanë.

4. Kur nëpunësit e shërbimit të jashtëm me gradë diplomatike/konsullore nga “Sekretari i parë” e lart punësohen në pozicione pune më të ulët se pozicioni që i korrespondon gradës, sipas përcaktimit të pikës 2, ata paguhen në masën 10 për qind më pak se paga që u takon në bazë të gradës, pavarësisht nga pozicioni i punës ku janë punësuar.

5. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, të emëruar në funksione drejtuese deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të cilët kanë gradë diplomatike/konsullore më të ulët se niveli i gradës që i korrespondon pozicionit të tyre drejtues, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të paguhen sipas pagës së pozicionit që gëzojnë, përkatësisht “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”-IIa, “Drejtor drejtorie”-IIb dhe “Përgjegjës sektori”-IIIa, të përcaktuara në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, por jo më shumë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Nëpunësit e tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që nuk gëzojnë të drejtën e gradës diplomatike/konsullore, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA MUJORE				
	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			
Grada diplomatike	Paga e grupit	Shtesa vjetore për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për gradë
1	2	3	4	5
Ambasador	9 000	2 %	0	100 000
Ministër fuqiptotë Ministër këshilltar Konsull i Përgjithshëm	9 000	2 %	0	90 000
Këshilltar	9 000	2 %	0	74 000
Sekretar i parë Konsull	9 000	2 %	0	55 000
Sekretar i dytë zëvendëskonsull	9 000	2 %	0	40 000
Sekretar i tretë Agjent konsullor	9 000	2 %	0	30 000
Atashe	9 000	2 %	0	20 000

VENDIM

Nr.19, datë 29.4.2004

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “EMIHEL” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, bordi i komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "EMIHEL" sh.p.k për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbi bazën e një analize të hollësishme të koston,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "EMIHEL" sh.p.k. për periudhën 1.1.2004 - 31.12.2004 të jetë 4,3 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “EMIHEL” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.20, datë 29.4.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
SHOQËRIA "SPAHIU-GJANÇ" SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, bordi i komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "SPAHIU-GJANÇ" sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "SPAHIU-GJANÇ" sh.p.k. për periudhën 1.1.2004 - 31.12.2004 të jetë 4,6 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria "SPAHIU-GJANÇ" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.21, datë 29.4.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
SHOQËRIA "WONDER-POWER" SHA**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, bordi komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "WONDER-POWER" sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "WONDER-POWER" sh.a. për periudhën 1.1.2004 - 31.12.2004 të jetë 4,4 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria "WONDER-POWER" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.22, datë 29.4.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
SHOQËRIA “ESSEGEI-SHQIPËRI-SMOKTHINA” SHKP**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, bordi i komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “ESSEGEI-SHQIPËRI-SMOKTHINA” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “ESSEGEI-SHQIPËRI-SMOKTHINA” sh.p.k. për periudhën 1.5.2003 - 30.4.2004, të jetë 3,75 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “ESSEGEI-SHQIPËRI-SMOKTHINA” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.23, datë 30.4.2004

**PËR MIRATIMIN E SASISË SË ENEGJISË ELEKTRIKE TË PËRLLOGARITUR PËR T'U
FATURUAR AFORFE PËR ABONENTËT FAMILJARË PA MATËS OSE ME MATËS
JASHTË KUSHTIT TEKNIK, PËR PERIUDHËN 1 PRILL 2004 - 30 SHTATOR 2004**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, pika 1, si dhe neni 52 pika 2, bordi i komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e paraqitur nga KESH sh.a. për faturimin aforfe të energjisë elektrike në abonentët familjarë pa matës ose me matës jashtë kushtit teknik, për periudhën 1 prill 2004-30 shtator 2004 dhe relacionin e përgatitur nga departamenti i tarifave dhe çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e sasisë së energjisë elektrike të përlllogaritur për t'u faturuar aforfe për periudhën 1 prill 2004 - 30 shtator 2004 sipas tabelës bashkëngjitur vendimit.
2. Në rastet kur matësit janë të dëmtuar dhe jashtë kushteve teknike të faturimit, faturimi do të bëhet bazuar në konsumin mesatar të faturuar të 3 muajve të fundit. Periudha e faturimit aforfe në këto raste të mos zgjasë më shumë se një muaj.
3. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi nr.4, datë 29.3.2001, si dhe vendimi nr.8, datë 23.5.2001 i Këshillit Drejtues të ERE-s shfuqizohen.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.24, datë 30.4.2004

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS KINDERHOUSE PËR NDRYSHIM
TARIFE**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26 pika 1 bordi i komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "KINDERHOUSE" për ndryshim tarife të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga departamenti i tarifave dhe çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqatës "KINDERHOUSE" për ndryshimin e tarifës së energjisë elektrike.
2. Aprovohet kalimi i këtij konsumatori nga grupi “Private-furnizuar TU” me tarifë 12 lekë/kWh në grupin “Buxhetore” me tarifë 9.5 lekë/kWh.
3. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema

KËRKESË

Shtetasi Emiljano Sollaku lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të nënës së tij, Liljana Sollaku.

KËRKUESI
Emiljano Sollaku

KËRKESË

Shtetasit Maksel Sehiti dhe Eriselda Sehiti, lindur dhe banues në Tiranë, kërkojnë shpalljen të zhdukur të babait të tyre, Selim Sehiti dhe caktimin e djalit të tij, Maksel Sehiti si kujdestar të pasurisë së babait të tyre.

KËRKUESI
Maksel Sehiti

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

- ♦ *SË SHPEJTI NË BOTIM, INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK*
- ♦ *PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE*

Doli nga shtypi më 27.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë